

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

10.03.2025

Ora 12:10

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim: “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.5, kundërshtimi i vendimit të regjistrimit të Partisë Mega”**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,  
z. Ilirjan Rusmali, z. K. Belo, z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** Partia Mega Z. Lefter Nika
- **Të tjerë:** KRIIK, z. P. Dhimitri (avokat), z.Th.Kiço (avokat)

**Z. L. Braho:** Përshëndetje! Çelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore nr.5 të datës 06.03.2025 me ankues Partia e Minoritetit Grek Për të Ardhmen Mega, me person të interesuar zoti Kristaq Kiço me objekt “Shfuqizimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.228, datë 03.03.2025 për regjistrimin si subjekt zgjedhor së Partisë së Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen Mega me kryetar zotin Kristaq Kiço dhe regjistrojnë si subjekt zgjedhor të Partisë Mega me kryetar zotin Lefter Nika. Atëherë sa vihet re nga kërkesa ankimore po ashtu dhe nga seanca e shqyrtimit të elementeve në fokus dhe të përmbajtjes, mosmarrveshja objektshqyrtimit duket që ka të bëjë me përfaqësuesin e subjektit zgjedhor Partia e Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen, por ka pretendime nga një kryetar i zgjedhur në raport me kryetarin që rezulton nga regjistri i Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Po ashtu dhe nga provat objekt

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

gjykimi rezulton se ka vendim gjykatë për regjistrimin e Partisë Mega me kryetar zotin Lefter Nika. Kjo vendimmarrje është ankimuar nga zoti Kristaq Kiço. Ka një vendim të gjykatës në lidhje me disponimin e ankimit që nuk e ka pranuar këtë ankim dhe në vijim në datën 7 Mars zoti Kristaq Kiço, rezulton se ka bërë ankim të veçantë ndaj vendimit të gjykatës për disponimin e ankimit që nuk e ka pranuar këtë ankim. Kjo është situata ligjore sot që flasim, ndërkohë që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka regjistruar si subjekt zgjedhor Partinë Mega me kryetar zotin Kristaq Kiço, që rezulton të jetë kryetari i fundit në regjistrin e gjykatës me një vendim të formës së prerë. E pranishme është trupa e KAS-it në përbërje të plotë dhe është zoti Lefter Nika, i cili pretendon se është kryetari i zgjedhur i Partisë Mega, përfaqësuar me avokatin e tij zoti Petraq Dhimitri, po ashtu është i përfaqësuar me prokurë të posaçme me avokat zotin Kristaq Kiço. Është dhe administrata e KQZ-së. Për efekt të procesverbalit prezantoni edhe njëherë palët e pranishme dhe pastaj ia japim fjalën partisë, përfaqësuesit e ankuesit dhe ankuesit vetë në lidhje me pretendimet shkurtimisht që ka, për kërkesën ankimore që ka depozituar.

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** Paraprakisht, sikurse u diskutua pak më përpara, ne kemi dy vendime të gjykatës të plota, kështu që i dorëzojmë për efekt të provës në këtë proces në statutin e partisë që u kërkua. Vendimet janë të plota, ai i regjistrimit të kryetarit të ri të partisë dhe i mospranimit të ankimit kundër vendimit për vërtetimin e faktit. Ankimi që kemi parashtruar para jush është një ankim i plotë formal, i cili drejtohet për shfuqizimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.228, datë 03.03.2025 për regjistrimin e subjektit zgjedhor të Partisë së Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen Mega, me kryetar zotin Kristaq Kiço dhe duke qenë se është bërë procedura formale, regjistrimi i një subjekti zgjedhor ose pasoja e kësaj të Partisë Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen me kryetar zotin Lefter Nika. Sikurse

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

e kemi parashtruar dhe në ankim, kjo lloj partie e përfaqësuar me një parti politike të regjistruar në listën e partive të Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës që ka Niptin e vet, përmes vendimin nr. 16 datë 23.11.2024 Komisioni Zgjedhor i kësaj partie, për arsye se janë zhvilluar zgjedhet aty ka vendosur që kryetar i kësaj partie të jetë fituesi i zgjedhjeve të brendshme për kryetar, zoti Lifter Nika. Në datën 28 ka një vendim të Këshillit Kombëtar të përfaqësuesve të partisë i cili ka shkrië organet e partisë për efekt të realizimit të zgjedhjeve të reja të partisë, në përfundim të afatit të vlefshmërisë së tyre. Me përfundimin e këtyre zgjedhjeve, në datën 10 kryetari i sapozgjedhur i partisë ka vepruar proceduralisht, duke bërë një kërkesë formale në gjykatës e Tiranës me objekt regjistrimin e regjistrit të partive politike pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kryetarit të ri të Partisë zotin Lifter Nika. Gjykata e ka pranuar kërkesën në seancën e datës 10.02 përmes vendimit nr.5 të kësaj date, të cilin ua kemi vënë në dispozicion. Fakti është se ky është një proces, sikurse Gjykata e Lartë ka trajtuar në jurisprudencën e vet me karakter gracioz ku nuk ka pasur palë të tretë, pra është një proces me palë kundërshtare, por nuk ka pasur as palë të tretë që të kishte ushtruar ankim. Kur gjyqtari e shpalli vendimin, në datën 3 të muajit Shkurt, kishim dijeni që në datën 27, 28 po themi të muajit paraardhës ishte bërë një ankim kundër këtij vendimi nga një person i tretë, që nuk ishte palë në proces. Këtij procesi i parapriu një procedurë regjistrimi i KQZ-së si subjekt zgjedhor, kur këtë kërkesë ne e shkruam dhe e bëmë gati në datën 24 të muajit Shkurt dhe aty u informuam që në datën 18 te këtij muaji, kryetari i mëparshëm i partisë kishte bërë dhe ai të njëjntën procedurë. Ndryshimi është sepse , duke qenë se ligji formalisht kërkon që të jesh i regjistruar në regjistrin e partive në Gjykatën e Shkallës së Parë në Juridiksionin e Përgjithshëm Tiranë, ai e kishte këtë regjistrim, por ndërkohë kishte humbur cilësinë si kryetar në datën 28 të muajit Shtator, kur këshilli drejtues i partisë vendosi shkrië organit të

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

partisë dhe daljen në zgjedhjet e reja brenda partisë. Ne bëmë aplikimin tonë, kemi dorëzuar dhe dokumentacionin bashkë me vendimet gjyqësore në gjykatë. Komisioneri ndërmori një procedurë formale dhe e miratoi kryetarin e mëparshëm të partisë, thjesht për faktin sepse në regjistrin publik të partisve politike në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës figuronte si kryetar, kryetari i mëparshëm. Këtu dua të sqaroj se kryetari i mëparshëm ka qenë në dijeni, që në datën 10 është marrë një vendim nga gjykata, në datën 18 ai ka parashtruar, ka bërë një aplikim në KQZ për të regjistruar subjektin zgjedhor, ka qenë në dijeni të atij vendimi. Formalisht nuk duhet ta bënte, pasi e kishte humbur këtë cilësi prej datës 28 të muajit Shtator, kur vetë këshilli drejtues i partisë i shkriu organet e partisë dhe funksionet e kryetarit i kaluan kryetarit të këshillit, do të thotë se ky person nuk kishte cilësi juridike për të aplikuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si titullar i kësaj partie për t'u regjistruar subjekt zgjedhor. Këtu kemi një kundërshti midis gjendjes juridike, do të thotë cilësisë së kryetarit dhe regjistrimit të cilësisë në regjistrin publik. Nuk është vendi këtu të ndalemi tek praktika e Gjykatës së Lartë, që i ka dhënë avantazh apo prioritet gjendjes juridike krahasuar me regjistrimin. Gjykata me të drejtë e regjistroi dhe ankimi që është paraqitur po në datën 24 kundër këtij vendimi, duke mos qenë palë në proces u vendos mospranimi i këtij ankimi. Qëllimi i vetëm ka qenë që ky vendim të mos lejojë të merrte formë të prerë, sikurse u trajtua ose u pranua në seancën që ishte pak më përpara, nuk është qëllimi i ish-kryetarit të partisë që të regjistrohet dhe të ketë një ecuri normale zgjedhore për këtë subjekt zgjedhor, por thjesht t'i "prishte punë" kryetarit të ri që të mos i bënte këto procedura. Pra nuk ka një pranueshmëri të kryetarit të ri nga kryetari i mëparshëm, e thënë me fjalë të thjeshta. Ne kemi një precedent të caktuar është një qëndrim i përpunuar nga Gjykata e Lartë në një çështje analoge lidhur nga një pritshmëri që kemi ne dhe kush është pritshmëria që kemi ne, që ky vendim gjyqësor i regjistrimit të marrë formë të prerë

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

në gjendjen që është, do të thotë që të regjistrohet në regjistrin publik partia politike në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranës kryetari i ri zoti Lefter Nika. Unë e kam cituar në ankim vendimin e Gjykatës së Lartë, trajtimi që Gjykata e Lartë i ka bërë aspekteve të këtij procesi dhe momenti procedural, se kjo është shumë e rëndësishme se kur palët e treta mund të kontestonin rezultatin e gjykimit të regjistrimit dhe atje thuhet shumë mirë ose me kundërpadi në atë proces, ose me ndërhyrje kryesore në atë proces. Moment tjetër procedural nuk ka, meqenëse u tha se është hapur një padi e veçantë kjo nuk trajtohet dhe nuk ka sens logjik, po themi juridik. Unë e kuptoj që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke i ndejtur strikt ligjit, do të pranojë regjistrimin si kusht për regjistrimin si subjekt zgjedhor të një partie politike, pra asaj çfarë shkruhet në regjistër, por ne kemi dy gjëra, legjitimitetin e pagës, e cila duhet trajtuar dhe interpretohet që e ka humbur në momentin që është shkrirë organi drejtues i partisë, nuk e ka më këtë legjitimitet të shkojë të aplikojë në KQZ dhe transkriptojë në përgjithësi në emër të partisë. E dyta një pritshmëri legjitime që ne e kemi dhe që bazohet me qëndrimin që Gjykata e Lartë ka mbajtur në një çështje analoge. Ne shpresojmë që në interpretim të ligjit dhe të gjithë praktikës ky komision të vendosë pro ankimit tonë, të dalë jashtë qëndrimit thjesht formalist të Kodit Zgjedhor lidhur me kriteret për regjistrimin e një subjekti zgjedhor. Prova janë ato që ne kemi depozituar. plus këto që sollëm të plota, që janë dy vendimet gjyqësore dhe statuti i partisë që ju me të drejtë kërkuat për të parë nëse ka diçka ndryshe. por që është i njëjti dhe kërkojmë nga ju që kjo kërkesë të pranohet. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit avokat! Fjala është për përfaqësuesit e palës së interesuar.

**Z.Th.Kiço(Avokat):** Faleminderit! Të nderuar anëtarë komisionit, ne përsëri këmbëngulim në të drejtën tonë që i kemi paraqitur Komisionit Qendror të

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

Zgjedhjeve, sipas praktikës që zbaton në emër të Kodit Zgjedhor vërtetimin, se në regjistrin e partive politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se në vendimin 50/85 të datës 21.06.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është miratuar krijimi i Partisë Minoritetit Grek për të Ardhmen me iniciale MG. Kryetar i partisë është zoti Kristaq Kiço. E lëshojmë këtë vërtetim me përgjigje të kërkesës së subjektit të interesuar me datën 09.01.2025. Mbas një dokumentacioni tjetër i jemi drejtuar në kohë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili ka pranuar kërkesën tonë për regjistrim dhe më mbrapa, me ardhjen e një subjektit tjetër i vetëquajtur dhe ai MEGA, duke përdhosur simbolet, vulën dhe sibmolet e partisë kërkon regjistrimin e saj duke pretenduar se ka një vendim gjykate jo të formës së prerë, por erdhi me dispozitivin dhe i kërkoi Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ta regjistruar dhe atë. Me të drejtë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i dha një farë kohe 5 ditore me qëllim që mos kishte diçka në avancë përse i përket vendimmarrjes ose marrjes së formës së prerë të vendimit, nuk është realizuar as kjo për arsye se ne në kohë kemi bërë ankimimin, pra Partia MEGA e ka ankimuar këtë, pavarësisht që këtu nuk është vendi për debat, konsideroj që është i njejtë subjekt me dy pretendues, gjë që e konsideroj ankimimin të ligjshëm përderisa dhe në vendimin e marrë nga gjyqtari parashikohet e drejta e ankimimit brenda 15 ditëve. Ne kemi shtruar këtë ankimim, pavarësisht se ka një praktikë që e konsideroj praktikë të gabuar, që e konsideron palë, i vënë në dy subjekte në një kohë që është një subjekt me dy pretendues dhe ka të drejtë të ankimojnë. Gjithsesi ne kemi ankimuar dhe vendimin për mospranimin e ankimimit tonë në Gjykatën e Apelit, ju thashë në datën 07.03.2025, jemi në kushte që zotit Kristaq Kiço nuk i është hequr legjitimiteti, siç pretendon pala tjetër në datën 23.11.2024, kur Këshilli i Përgjithshëm drejtues, Këshilli Kombëtar i përfaqësuesve të Partisë MEGA u kemi vënë në dispozicion statutin, të nderuar anëtarë ku thotë: Organi më i lartë i Partisë MEGA është kongresi, një kongres që po të shikoni dhe

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

në ankimin e zotërinjve nuk e përmendi fare. Pra është kongresi ai që vendos miratimin e kandidaturave për kryetar partie, është kongresi ai që vendos për miratimin e Komisionit të Zgjedhjeve dhe komisioneve të tjera. Këta duke anashkaluar krejt kongresin mbledhin këshillin kombëtar të përfaqësuesve dhe pa asnjë të drejtë, që nuk parashikohet as në kushte anormale dhe urgjente shkrijnë, siç pretendojnë të gjithë organet e tjera në një kohë që kryetari aktual dhe e gjithë kryesia e këshillit të përgjithshëm janë në funksion të Partisë MEGA me drejtues Krisaq Kiço. Pra po të shikoni këta zotërinj në datën 23.11.2024 kanë mbledhur Këshillin Kombëtar të Përgjithshëm dhe kongresin e kanë bërë më mbrapa. Pra kanë vendosur karrocën para kalit, pra në vend që të bëjnë kongresin dhe të bëjnë atë çfarë ishte për të bërë, e zhvendosin duke pretenduar se Kristaq Kiço nuk ka të drejtën legjitime që të depozitojë kërkesë në KQZ për regjistrimin. Pra unë nuk kam pse ta vazhdoj këtë debat, jam dakord me vendimin që ka marrë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si vendim i drejtë se për një parti formalisht që është, ka zbatuar rregullat dhe gjithë kërkesat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të ligjit zgjedhor për regjistrimin e partive në zgjedhjet parlamentare të ardhshme. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Administrata e KQZ-së çfarë mendimi ka?

**Znj. P. Doçaj:** Për ekonomizim të kohës mos të përsërisim, se u tha edhe nga pala ankuese. Mendoj se duhet të referohemi në dy momente procedurale, e para në datën e depozitimit të dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi, a e ka pasur një vërtetim nga regjistri i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe e dyta, po sot që jemi në një tjetër organ drejtues, a e ka këtë vërtetim nga gjykata, pra në cilat kushte jemi? Përsa i përket pjesës së konfliktit mendoj se duhet të ezaurohet midis palëve, ne këtu do të duhet t'i qëndrojmë strikt ligjit dhe dokumentacionit, që ligji na kërkon për

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

regjistrimin e një partie politike si subjekt zgjedhor. Këtë ka bërë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, është referuar në nenin 64, pika 2, germa a në të cilin theksohet se një parti politike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor dhe, duhet ndër të tjerave të plotësojë strikt edhe këtë dokumentacion vërtetimi që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Këtë vërtetim nuk e ka depozituar pala ankuese dhe për këtë pavarësisht se i është lënë dhe kohë nga ana e Komisionerit derisa vendimi të merrte formë të prerë, pra i është lënë kohë e mjaftueshme për të depozituar këtë vërtetim, gjë e cila nuk ka ndodhur as në datën e shpalljes së vendimit, në datën 03.03.2025 dhe mesa duket as në ditën e sotme nga dokumentacioni provues që pala ka paraqitur, nuk rezulton që të jetë ndër këto dokumenta edhe ky vërtetim i depozituar nga gjykata.

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Nuk besoj se ankimuesi kishte pretendime se e dispononte vërtetimin, pra ishte i qartë që nuk e ka vërtetimin, u dhanë dhe arsyet se pse nuk e ka vërtetimin, kështu që e kuptojmë, Komisioneri ka qëndruar strikt pjesës së vërtetimit. Kisha një pyetje për të dyja palët. Këtu kemi një vendim nr.2, datë 28.09.2024 që është i organeve të Partisë MEGA dhe në pikën 2 citohet: Shkrirja e të gjithë organeve drejtuese dhe kolegjiale të partisë duke përfshirë strukturat e kryetarit, kryesisë Këshillit Kombëtar të përfaqësuesve. Po ashtu në nenet 30 dhe vijues të statutit të partisë është përcaktuar dhe një komision qendror i kontrollit dhe respektimit të statutit. Ky komisioni është shkrirë edhe ky me vendimin 2, apo nuk është shkrirë? Ka qenë ekzistent gjatë periudhës së zgjedhjeve, pas zgjedhjeve e tjerë. Në qoftë se ka qenë ekzistent, a ka pasur ndonjë procedurë ankimore në lidhje me organizimin e zgjedhjeve?

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** Atëherë, sipas procedurës që statuti i partisë parashikon, ka një vendim të Këshillit Kombëtar të përfaqësuesve të partisë që ka vendosur për shpalljen e datës së zgjedhjeve dhe shkrirjen e të gjitha organeve dhe strukturave, përfshirë dhe kryetarin e partisë për arsye se kishte mbaruar afati i kryetarit dhe duhet të zgjidhej një kryetar i ri mbi bazën e zgjedhjeve të brendshme, me parimin një anëtar, një votë. Në lidhje me pretendimet për procesin e brendshëm, nëse e kuptova pyetjen nuk ka pasur asnjë pretendim, në qoftëse do të kishte një pretendim sepse ka pasur dhe që kanë votuar kundër në atë proces, por shumica kanë votuar për kryetarin e ri. Pra kryetari i mëparshëm ka qenë në dijeni të procedurës, nuk ka ndërmarrë asnjë hap për kundërshtimin e procedurës, në asnjë lloj mënyre. Gjykata e Lartë te ai qëndrim që ka mbajtur për rastin, po them një rast identik e thotë dhe mënyrën sesi këto kontestohen dhe nuk ka pasur as më përpara se ne do t'i drejtohem gjykatës dhe as sot që flasim bashkë ndonjë pretendim formal ligjor, pra në mënyrën se si ligji do të parashikohet se ato duhet të parashtrihen, që të kundërshtohet procedura e brendshme e zgjedhjes së kryetarit të ri të partisë.

**Z. L. Nika, Kryetar i PMG:** Pas zgjedhjeve, në datën 5 Janar legjitimuam dhe me kongres të gjithë procedurën që bëmë, meqënëse ra fjala që nuk kishim bërë kongres, e kemi bërë edhe kongresin. E gjithë procedura në vijim u dorëzua edhe në bazë të procedurave që kemi, që të vazhdonim me deputetin Niko Gurin, i cili është deklaruar në kuvend që është deputet me Partinë MEGA. Kemi dhe vërtetimet e tij të cilat dhe mund t'i depozitojmë. Nuk ka pasur asnjë pretendim nga pala tjetër që të merrte pjesë ose të kishte ndonjë kundërshtim nga këto zgjedhje.

**Z. L. Braho:** Këtë organin nuk e kuptova, a është apo nuk është ky organi? Ka tre anëtarët që duhet të ketë ky Komisioni Qendror i Kontrollit dhe Respektimit të

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

Statutit. apo është shkrire dhe ky me vendimin e Shtatorit 2024. Pra ky ka qenë ekzistent gjatë periudhës së zgjedhjeve në parti apo jo?

**Z. L. Nika, Kryetar i PMG:** Është shkrire, janë shkrire ato procedurat përveçse anëtarëve që ishin pjesë e formimit të organeve zgjedhore.

**Z. L. Braho:** Të bëj një pyetje, në qoftë se një nga palët do të kishte pretendimet, ku ankohej, sepse sipas statutit ky është organi që shqyrton ankimet, procedimet disiplinore e tjerë, pra në qoftëse pala e tjetër e interesuar, pra Kristo Kiço do të kishte pretendime në lidhje me këto procedura, mund të ankohej së brendshmi në parti?

**Z. L. Nika, Kryetar i PMG:** Mund të merrte pjesë.

**Z. L. Braho:** Pjesëmarrja është tjetër gjë dhe ankimi është tjetër gjë.

**Z. L. Nika, Kryetar i PMG:** Ishin krijuar mundësitë për çdo anëtar, për çdo pjesë që të mund të merrte pjesë edhe në zgjedhje dhe të krijohet mundësia e procesit që të vazhdonin.

**Z. L. Braho:** Dakord. Po!

**Z.Th.Kiço(Avokat):** Pra vetë e pranojnë dhe e deklarojnë që i kanë shkrire organet, pra këta kanë mbajtur një kongres pa komision zgjedhor dhe pa komision të mandateve, të cilat atribut ose tager i ka kongresi. Këta kongresin e kanë bërë dy muaj më mbrapa se të mbyllen, të shkrijnë dhe të ngrijnë në emër të Këshillit

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

Kombëtar të Përfaqësuesve. Pra këtu ka një anomali, kot që e diskutojmë. Pra në këto kushte këta kanë vajtur në zgjedhje, siç pretendojnë kanë bërë zgjedhje pa komision, se komisioni përbëhet nga 3 anëtarë nga të cilët ne disponojmë deklaratat e dy anëtarëve nga këta, që kanë dhënë dorëheqjen në kongres. Kongresi i ardhshëm siç u bë nga Partia e mirëfilltë MEGA ka zgjedhur komision, ka caktuar datë për zgjedhjen e kryetarit, ka kandiduar kandidaturat, pra kjo është procedura e rregullt ku thotë: Kongresi i programuar miraton kandidatët për kryetarë të partisë, që nuk e thonë zotërinjtë - neni 22 i statutit, kongresi me shumicë votash zgjedh Komisionin Zgjedhor të partisë - neni 22 i statutit. Kongresi i programuar i partisë paraprin konferencën e programit të degëve së partisë, që bëhet fjalë në këtë rast dhe kongresi me shumicë votash zgjedh komisioni statutor të partisë, pra zotërinjtë janë në kushte që nuk kanë bërë kongres dhe pretendojnë se dhe një organ tjetër që është organi më i lartë mes 2 kongreseve kanë shkrië strukturat dhe kanë bërë zgjedhjet. Si i kanë bërë zgjedhjet është problemi i tyre. Gjithsesi për të drejtën e ankimimit, ku do ta bënim ne? E bëmë në gjykatë, në datën 8 Janar i kemi kërkuar Gjykatës me padi themelin që të gjykojë për anormalitetin e jetës së brendshme të Partisë MEGA, pra kjo gjykatë do ta ndajë këtë gjë. Pavarësisht që Gjykata e Shkallës së Parë ka emëruar në këtë rast, këta kanë shkelur çdo lloj formati, kanë emëruar zotin Lefter Nika, gjë që nuk është kompetencë e saj. Kompetenca e saj është që të ushtrojë legjitimitetin e vendimmarrjes së organeve drejtuese. Gjykata e Tiranës shikon fare mirë se nuk kanë bërë kongres dhe thotë që të miratohet xzgjedhja e kryetarit të ri pa kongres. Nuk thotë në një dokument që a keni miratimin formal nga kongresi për 3 kandidaturat që ishin dhe doli zoti Nika kryetari i partisë, por nuk e kërkon këtë, nuk kërkon asnjë vendimarrje, nuk ka asnjë të tillë, se ka vendimarrje që miraton gjykata, vendimarrjen e kongresit ose të këshillit të përgjithshëm drejtues, nuk e kanë as atë. Nuk kanë depozituar as anëtarët e komisionit, qoftë zgjedhor apo statutor

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

dhe në këto kushte gjykata i jep një miratim, që është një shembull se si mund të abuzohet dhe të vendoset në partitë politike në Shqipëri.

**Z. L. Braho:** Ka ndonjë pyetje nga kolegët?

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** Këshilli drejtues i partisë sikurse u tha, nuk është një autoritet i brendshëm i partisë që varet nga kryetari i ri i partisë, kjo duhet kuptuar fillimisht. Ka pasur një komision atje, ku mund të ankimonte çdo lloj vendimi pala tjetër ose ish kryetari i partisë dhe nuk ka bërë ndonjë ankim. Dhënia e dorëheqjes që ne tani po e dëgjojmë, por mund të kenë qenë dy persona po themi, që kanë pasur një lidhje personale siç ndodh me ish kryetarin e partisë. Shkrirja e organeve të partisë, ku përfshihet dhe kryetari i partisë nuk është atribut i kryetarit të ri të partisë, nuk ka asnjë rol në këtë proces. Vonesa e arsyetimit të vendimit të gjykatës se, a do të ishte regjistruar ky vendim nuk do të ishte ky debat, nuk është as atributi ynë dhe ne as nuk ndikojmë dot në atë pjesë. U pretendua nga KQZ-ja se, meqënëse m'u dha fjala na u dha 5 ditë afat, se brenda këtij 5 ditsh-it ne do të kishim sjellë vërtetimin nga Gjykata e Tiranës. Ju thashë u vonua 30 ditë arsyetimi i vendimit, por kjo nuk ka lidhje me ne, me sjelljen e kryetarit të ri të partisë ose ankuesi në këtë proces. Pra jemi pa rol në këtë proces dhe ne kemi ndjekur thjesht rrugën ligjore dhe gjithë aspektet që pretendoi zotëria, janë aspekte që janë gjykuar ng Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës kur ka marrë vendimin përkatës, i cili për ne ligji është i formës së prerë, por që formalisht është çështje që mund të jetë shtyrë për arsye të qëndrimit që është bërë më parë. Faleminderit!

**Z. I.Rusmali:** Administrata e KQZ-së tha këtu që shqyrtimi nga KQZ-ja i dokumentave të subjekteve elektorale është një proces formal. Ka një listë aktesh që

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

kërkohen që të depozitohen dhe KQZ-ja i bën vetëm çek listës së këtyre akteve. KQZ-ja thotë: Në listën e këtyre akteve mungon një dokument në kërkesën tuaj. Ju përpiqeni të shpjegoni rreth këtij fakti, por ju dokumentin nuk e keni, do të thotë ju bini dakord që ky dokument mungon në listën tuaj të akteve.

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** Ju thashë, vërtetimi nga regjistri i partive dhe ne e pranojmë faktin, pra ajo formalisht ligji kërkon është që kryetar i partisë sipas regjistrimit është kryetari i mëparshëm i partisë. Po pse ndodh kjo, prandaj jemi këtu sepse e drejta e fituar nga kryetari i ri nuk ka gjetur pasqyrim në regjistër, por jo për arsye që lidhen me kryetarin e ri. Pra në datën 10...

**Z. I.Rusmali:** Këtë e shpjeguat, problemi është që ju keni përballë KQZ-në pse ju mendoni që KQZ-ja duhet ta merrte të mirëqenë justifikimin dhe të hiqte dorë nga një kërkesë specifike e ligjit?

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** Për arsye se ne çuam një shkurtim të vendimit të Gjykatës së Tiranës sepse nuk ishte arsyetuar vendimi në atë periudhë dhe u vonua, ju thashë 30 ditë dhe thamë që ky është shkurtimi i vendimit të Gjykatës së Tiranës, është një proces pa palë dhe qëndrimi që është mbajtur, ne po flasim këtu me ligj është që ky është një vendim i formës së prerë, tej faktit që një i tretë ka parashtruar ankim dhe ai do të ndjekë rrugën e vet. Kjo është situata, ne po bëjmë një balancë të gjendjes ligjore me regjistrimin e gjendjes ligjore, kush është prioriteti që i ka dhënë praktika gjyqësore për atë çfarë ne përfaqësojmë në këtë çështje, t'i japim prioritet gjendjes juridike sesa regjistrimit të saj. Ajo është një formalitet regjistrimi që ne e pranojmë e që nuk ekziston sigurisht.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

**Z. I.Rusmali:** Domethënë ju thoni që KQZ-ja bën gabim në qoftë se e respekton germën e ligjit, duhet të futet në thelbin e çështjes. Nuk është se jeni duke i dhënë KQZ-së një kompetencë që ligji nuk ja jep kompoetencën për të shqyrtuar dhe për të vendosur lidhur me një konflikt që ju keni brenda vetes?

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** KQZ-ja në momentin që ka pasur një çështje problematike të kësaj natyre ku është përfshirë e ka një precedent, e ftojme KQZ-në, KAS-in në këtë rast që të ndjekë precedentin. Nuk flet për ne, por flet për rastin dhe ne..

**Z. I.Rusmali:** Nuk është në favorin tuaj.

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** Precedenti lidhet me të drejtën e ankimit të vendimit të gjykatës, por nuk ka palë kundërshtare.

**Z. I.Rusmali:** Precedenti i KQZ-së lidhet me qëndrimin që mban KQZ-ja si organ administrativ, lidhur me dokumentacionin që depozitohet nga subjektet dhe qëndrimi koherent i KQZ-së ka qenë që KQZ-ja nuk futet në thelbin e konflikteve të partive politike, por shqyrton vetëm dokumentacionin që ato sjellin. Konfliktet kanë instancë tjetër ku mund të zgjidhen, ky ka qenë precedenti i KQZ-së. Gjykimi që ju bëni lidhur me vlefshmërinë e akteve të gjykatave, lidhur me faktin që një vendim është i ankimueshëm apo jo është një gjykim që ju mund ta bëni pranë instancave gjyqësore, KQZ-ja do një copë letër e cila t'i japë një informacion ligjor. E keni këtë letër apo nuk e keni? Pala tjetër që e ka sjellë këtë letër e ka të kundraligjshme këtë letër apo nuk e ka? Këto janë pyetjet që ne bëjmë dhe për këtë ju mund të na ndihmoni duke na dhënë përgjigje.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** Ju shpjegoja po jua shpjegoj prapë, pala tjetër thjesht për arsye se është i regjistruar në regjistrin e partive politike të Gjykatës së Tiranës, ka paraqitur kërkesë për regjistrimin si subjekt zgjedhor të partisë me kryetar...

**Z. I.Rusmali:** Vërtetimin nga gjykata e ka të ligjshëm apo e ka të paligjshëm? Na thoni se cili është?

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** Ne nuk kemi paraqitur pretendime kundër vërtetimit, ne po themi tjetër gjë, që ish kryetari i partisë e ka humbur legjitimitetin që të veprojë si titullar ose personi që aplikon si subjekt zgjedhor në KQZ, prej momentit kur është shkruar si strukturë nga këshilli.

**Z. I.Rusmali:** Kjo do të thotë që gjykata që i ka dhënë një vërtetim ish kryetarit të partisë, ka shkelur ligjin?

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** Më kupto, gjykata është gjykata dhe regjistri është regjistri. Regjistri ndodhet pranë gjykatës.

**Z. I.Rusmali:** Kush e administron regjistrin?

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** Gjykata e Tiranës.

**Z. I.Rusmali:** Ai institucioni që administron regjistrin ka lëshuar një vërtetim, këtë vërtetim e ka lëshuar në kundërshtim me ligjin apo në përputhje me ligjin?

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** Edhe një herë, i është refëruar ajo gjendjes juridike në datën e lëshimit të vërtetimit. Gjendja juridike në datën e lëshimit të vërtetimit është që ka një vendim gjyqësor të datës 10 të muajit Shkurt që kryetari, ai që ka marrë atë vërtetimin që ju thoni, nuk është më kryetari i partisë. Duke mos pasur këtë cilësi dhe thjesht je i regjistruar si i tillë, kur nuk jep avantazh regjistrimi apo gjendja jote ose cilësia si kryetar, këtë po debatojmë ne sot.

**Z. L. Braho:** Dakord. Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera, kalojmë në konkluzionet përfundimtare, gjithashtu është për t'u theksuar që kur administrohen në cilësinë e provës së vendimeve të plota të Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vjen statuti i Partisë MEGA. Palët nuk kishin ndonjë kundërshtim në lidhje me këto prova.

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** Kemi sjellë dhe prova të tjera për të paraqitur, që i bëtë pyetje zotërisë në lidhje me pjesëmarrjen në zgjedhje për kandidatë.

**Z. L. Braho:** Dakord, i paraqisni dhe ato. Kështu që kalojmë në konkluzionet përfundimtare. Fjala fillimisht i jepet ankuesit, përfundimisht çfarë kërkoni?

**Z. P. Dhimitri (Avokat):** Për të mos u zgjatur, ne kërkojmë sikurse e kemi parashtruar, të pranohet ankimi që ne kemi parashtruar para jush. Të shfuqizohet vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.228, të datës 03.03.2025 për regjistrimin e subjektit zgjedhor të Partisë Minoriteti Grek për të Ardhmen MEGA me kryetar të zotit Kristaq Kiço dhe duke qenë se ne kemi aplikuar brenda afatit ligjor, regjistrimi i subjektit zgjedhor të Partisë Minoritetit Grek me kryetar zotin Lefter Nika. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

**Z. L. Braho:** Po, pala e interesuar përfundimisht?

**Z.Th.Kiço(Avokat):** Kërkojmë mospranimin e ankimimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e Partisë MEGA.

**Z. L. Braho:** Përfaqësuesja e KQZ-së?

**Znj. P. Doçaj:** Lënien në fuqi të vendimit nr.228, datë 03.03.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe rrëzimin e ankimit si i pabazuar në lidhje me provat.


**Z. L. Braho:** KAS-i do të tërhiqet për vendim.

**Rifillon Seanca**

**Ora 13:00**

**Z. L. Braho:** Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.5, të datës 06.03.2025 me ankues Partia e Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen Mega, përfaqësuar nga Kryetari i Partisë Lifter Nika, me person të interesuar zotin Kristaq Kiço me objekt shfuqëzimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.228, datë 03.03.2025 për regjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë së Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen, me kryetar zotin Kristaq Kiço dhe regjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë Minoritetit Grek për të Ardhmen, me kryetar zotin Lifter Nika. KAS pasi u këshillua dhe pasi dëgjoi palët ankuese dhe personin e interesuar dhe KQZ-në vendosi: Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.5 të datës 06.03.2025 me ankues Partia Mega përfaqësuar nga Kryetari i Partisë zoti Lifter Nika. Ky vendim hyn në

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 10.03.2025*

fuqi menjëherë. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e tij në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. U shpall sot në datë 10 Mars 2025. Seanca deklarohet e mbyllur.

**Vendimi nr.15**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona UKCAMAJ*

